

# KREDIA KONSUMATORE

BROSHURË INFORMATIVE PËR KONSUMATORËT



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

## PËRMBATJA

Të përgjithshme .....	3
Kredia Konsumatore .....	4
Çfarë informacioni duhet të dini para se të aplikoni për përfitimin e një kredie konsumatore.....	9

2





## KREDIA

mund të përkufizohet si një veprimtari bankare, përmes së cilës banka lëvron ose vë në dispozicion të klientit të saj një shumë të caktuar parash, në këmbim të së drejtës së ripagimit të shumës së livruar, bashkë me interesin ose komisionet e tjera bankare mbi këtë shumë.

# TË PËRGGJITHSHME

## INTERESI I KREDISË

përfaqëson “çmimin” që duhet paguar nga Klienti për kohën e përdorimit të parave dhe që shprehet si përqindje periodike fikse ose e ndryshueshme sipas informacionit parakontraktor dhe/ose marrëveshjes së kredisë.

## KOSTOJA TOTALE E KREDISË

përfaqëson tërësinë e të gjitha shpenzimeve të Klientit lidhur me kredinë, duke përfshirë edhe interesat e kredisë, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që Klienti paguan në lidhje me marrëveshjen e kredisë sipas kushteve të saj. Për të pasur një pasqyrim të plotë në vendimarrje dhe përtëkrahuar koston totale të kredisë ndërmjet bankave, por edhe me vetë interesin e kredisë, rekomandohet që Klienti t’i referohet Normës Efektive të Interesit (NEI) që është kostoja totale e kredisë e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë.



## KREDIA KONSUMATORE

Kredia konsumatore është një produkt bankar, në bazë të të cilit Banka lëvron ose vë në dispozicion të Klientit një shumë të caktuar parash, - me qëllim që Klienti të blejë apo të përdorë mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake dhe që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit të tij, - përkundrejt detyrimit të Klientit për ripagimin, me këste periodike ose në afatin e maturimit, të

shumës së livruar apo të vënë në dispozicion të tij nga Banka, bashkë me interesin mbi shumën e kredisë.

Klienti i kredisë konsumatore gjen një mbrojtje të veçantë nga kuadri ligjor dhe konkretisht Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, aktet nën-ligjore të nxjerra në zbatim të tij, Ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregulloret



e Bankës së Shqipërisë të nxjerra për të rregulluar këtë marrëdhënie. Klienti i kredisë konsumatore është individ (personi fizik) që aplikon për kredi për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit.

Në përgjithësi, kredia konsumatore është ajo kredi që i jepet klientit për qëllime personale, familjare apo

shtëpiake etj.

Kredia hipotekore [nëpërmjet së cilës financohet blerja ose ndërtimi i plotë ose i pjesshëm i një prone të destinuar për banim (shtëpi, apartament) ku klienti është blerësi ose poseduesi i pronës së destinuar për banim], nuk përfshihet në kreditë konsumatore dhe i nënshtrohet në një pjesë të saj kushteve të ndryshme nga kredia konsumatore<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Për të verifikuar listën e plotë të kredive të cilat nuk u nënshtrohen rregullave të kredive konsumatore Klienti mund t'i referohet nenit 44 të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" i ndryshuar.

## NË KREDITË KONSUMATORE NUK PËRFSHIHEN:

kreditë për të cilat sipas kushteve të publikuara nga Banka është e nevojshme garantimi me hipotekë mbi pasuri të paluajtshme ose të drejta të lidhura me to;

A

kreditë qëllimi i të cilave është fitimi/marrja ose ruajtja e të drejtave të pronësisë mbi tokën ose mbi ndërtesa ekzistuese apo të projektuara;

B

kreditë për të cilat Klientit i kërkohet që të vendosë peng/kolateral një send (send të luajtshëm) si garanci për kredinë, në posedimin e Bankës dhe ku të drejtat e Klientit ndaj sendit të lënë peng ose si kolateral financiar janë të kufizuara deri në shlyerjen e kredisë;

C

D

Overdrafti  
(Teprica Debitore në Llogari)  
me afat 1 (një) muhor.

## VEÇORITË KRYESORE TË KREDISË KONSUMATORE NË DALLIM NGA LLOJET E TJERA TË PRODUKTEVE TË KREDISË JANË:

1

Në kredinë konsumatore shuma e kredisë nuk mund të jetë më e vogël se 30 mijë Lek ose më e madhe se 10 milionë Lek;

2

Klienti/Konsumatori ka të drejtë të marrë me shkrim një kopje të informacionit parakontraktual të specifikuar sipas kushteve të përcaktuara.

3

Klienti/Konsumatori ka të drejtë të marrë një kopje me shkrim të kontratës/marrëveshjes së kredisë.

4

Klienti/Konsumatori ka të drejtën të tërhiqet nga marrëveshja dhe/ose kontrata e kredisë konsumatore pa dhënë ndonjë arsye për këtë qëllim, brenda një periudhe kalendarike 14 (katërbëdhjetë) ditore, duke filluar ky afat nga dita e arritjes së marrëveshjes ose lidhjes së kontratës, ose nga data kur konsumatori merr dijeni për kushtet kontraktuale (nëse kjo e fundit është e mëvonshme). Nëse klienti e ushtron këtë të drejtë dhe kredia është livruar (disbursuar), klienti duhet t'i rikthejë Bankës shumën e kryegjësë (principalit) dhe interesit të rrjedhur për ditët përkatëse, si dhe shpenzimet e mundshme të bankës të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj kredie, por nuk ka penalitete për tërheqjen nga marrëveshja/kontrata e kredisë;

5

Banka nuk mund ndryshojë kushtet e kontratës së kredisë konsumatore, veçanërisht metodën/metodologjinë e përlogaritjes së normës së interesit dhe elementet e saj, pa marrë më parë pëlqimin e klientit/konsumatorit.

6

Klienti/Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para përfundimit të afatit të kredisë, shlyerje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve të tij të lindura nga kontrata e kredisë konsumatore. Në këtë rast, konsumatorit i lind e drejta e një reduktimi të kostos totale të kredisë. Më konkretisht, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit, Klienti detyrohet t'i paguajë Bankës edhe një kompensim, i cili nuk tejkalon 2 (dy) përqind të shumës së kredisë së paguar para afatit; dhe nëse kjo periudhë nuk kalon 1 vit, kompensimi nuk tejkalon 1 (një) përqind të shumës së kredisë së paguar para afatit. Kompensimi për shlyerjet e parakohshme nuk aplikohet: (i) nëse shlyerja realizohet në bazë të një kontrate sigurimi, e cila ka si qëllim shlyerjen e kredisë; (ii) për kredinë kufi (overdraft-in); dhe (iii) nëse shlyerja e kredisë para afatit i përkon një periudhe për të cilën norma e kredisë nuk është fikse;

7

Klienti/Konsumatori ka të drejtë të paraqesë pranë Bankës, ankesë për çdo cënim të të drejtave që kuadri ligjor parashikon për konsumatorin dhe Banka është e detyruar t'i japë përgjigje me shkrim klientit mbi ankesën, brenda afatit kohor të përcaktuar në aktet rregullative të bankës.

Shënim:

Likujdimi i parakohshëm i kredisë – Pavarësisht se komisionet për mbylljen e parakohshme të kredisë nuk përfshihen në përlogaritjen e Kostos Totale në disbursimin e saj (ose NEI), një klient i kredisë konsumatore duhet të ketë parasysh edhe këtë element gjatë aplikimit për kredinë konsumatore. Duke qenë se ligji parashikon komisione të ndryshme në bazë të mënyrës së aplikimit të normës së interesit dhe momentit kur shlyerja e parakohshme ndodh, Klienti duhet të sigurohet që banka ka aplikuar komisionin e saktë në kontratën e kredisë konsumatore, sikurse e parashikon ligji, pasi ky është një element kostoje që i shtohet totalit të kostos së kredisë në momentin kur ndodh.

## ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË DINI PARA SE TË APLIKONI PËR PËRFTIMIN E NJË KREDIE KONSUMATORE



Në momentin që Ju vendosni të aplikoni për një kredi konsumatore, Ju duhet të kërkonte nga Banka që të jeni të mirëinformuar në lidhje me karakteristikat e kësaj kredie në mënyrë të plotë, të qartë dhe të kuptueshme. Informacioni ju shërben Juve për të bërë një vlerësim të plotë të produktit të kredisë që Ju përshtatet më mirë si dhe për të bërë një krahsim të ofertave

të kredive konsumatore që bankat kanë paraqitur në tregun bankar.

Banka ka detyrimin t'Ju sugjerojë, llojin dhe vlerën më të përshtatshme të kredisë, ndërmjet kredive që ofron, duke marrë parasysh gjendjen financiare dhe/ose aftësinë paguese Tuaj, avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë produktin e propozuar dhe qëllimin e kredisë.

Në rast se vendosni të aplikoni për kredi konsumatore, Banka në rast mosmiratimi të kredisë konsumatore duhet t'Ju informojë mbi arsyet përkatëse. Ju mund të kërkoni në çdo moment nga Banka që të njiheni me arsyet e refuzimit të aplikimit Tuaj për kredi konsumatore.

Banka ka detyrimin ligjor për t'Ju paraqitur në formë të shkruar informacionin e duhur dhe kryesor, në formën e informacionit parakontraktor (të parashikuar edhe në Rregulloret e Bankës së Shqipërisë për kredinë konsumatore), përpara pranimit të çfarëdo oferte apo nënshkrimit të kontratës së kredisë konsumatore. Në informacionin parakontraktor paraqiten

të gjitha kushtet e aplikuarra për formën e kredisë konsumatore për të cilën Ju po aplikoni, në mënyrë që të keni njohuri të plota për transaksionin e lidhjes dhe ekzekutimit të kontratës, si dhe të keni mundësi të zgjidhni ofertën më të leverdishme në treg. Në rast se Banka nuk Ju pajis me informacionin parakontraktor, Ju duhet të insistoni në zbatimin e këtij detyrimi ligjor.

Do të tërhiqim vëmendjen Tuaj që përpos sa parashikohet më lart, të tregoni kujdes dhe krahasoni ofertat e Bankave, duke pasur parasysh që elementët kryesorë dhe kufij të kredisë konsumatore janë të përcaktuar me ligj, ndërkohë që brenda këtyre kufijve variojnë edhe ofertat e secilës Bankë.

Konkretisht:



A

Shuma e Kredisë konsumatore, do të jetë sipas marzheve të ofertës së Bankës por sipas Ligjit nr. 9902, datë nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, do të variojë në vlerat nga Lek 30,000 deri në Lek 10,000,000. Brenda vlerës së ofertës, Ju mund të zgjidhni shumën që Ju nevojitet.

**B**

Kohëzgjatja e Kredisë është afati i kredisë konsumatore e cila varion nga Banka në Bankë. Ligji nuk parashikon afate maksimale të kohëzgjatjes së kredisë. Në varësi të shumës së kredisë, kohëzgjatjes së kredisë, normës së interesit, metodës/metodologjisë së përlllogaritjes së tij dhe mënyrës së ripagimit të kryegjësë (me këste periodike ose në përfundim të afatit të maturimit) do të përcaktohet edhe vlera e këstit dhe numri i tyre.

**C**

Norma e interesit të kredisë është element thelbësor dhe që në varësi të ofertës së paraqitur nga Banka në treg mund të jetë e shprehur si përqindje periodike fikse ose e ndryshueshme. Ju duhet të tregoni kujdes që të informoheni nga Banka lidhur me kushtet që përcaktojnë mënyrën e zbatimit dhe përlllogaritjes së normës së interesit, çdo indeks ose normë reference të zbatueshme, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit, si dhe mënyrën e njoftimit Tuaj për çdo ndryshim të mundshëm. Në rast se norma e interesit është e ndryshueshme kërkoni t'Ju bëhet e qartë matja e indekseve të ndryshueshëm me qëllim që të keni mundësi të ndiqni korrektësinë e përlllogaritjeve që do të bëhen nga banka. Bankat aplikojnë norma vjetore interesi të ndryshme me kushte të ndryshme.

# D

Norma efektive e interesit (NEI) shpreh totalin e kostos së kredisë duke përfshirë dhe interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që kredimarrësi paguan në lidhje me kredinë e marrë. Për qëllime të llogaritjes së NEI-t totali i kostos së kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI-t, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratën e kredisë, kostot e pagueshme nga klienti lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, një noter, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë jo të detyrueshme, shpenzime për komisione të aplikuar për fondet e papërdorura dhe shpenzime komisionesh për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin që :

- kontrata e kredisë është e vlefshme për periudhën e rënë dakord, dhe
- palët plotësojnë detyrimet e tyre sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në kontratën e kredisë, dhe
- përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI-t mbeten të pandryshuara (fikse) deri në fund të kontratës së kredisë.

Ju duhet t'i kushtoni vëmëndje dhe të qartësoheni plotësisht mbi komisionet dhe shpenzimet që duhet të paguani lidhur me kredinë të cilat përfshihen në koston totale të kredisë.

## SHSEMBULL

Shuma e kredisë është 100,000 lekë. Norma nominale e interesit të kredisë është 10% në vit. Komisioni i disbursimit është 1% e shumës së kredisë (1,000 Lekë). Ripagimi i kredisë do të jetë për 12 muaj dhe do të paguhet me këste të barabarta mujore. NEI i kredisë do të do të jetë ~14.76% vjetore dhe llogaritet sipas formulës<sup>2</sup>:

$$P = \sum_{j=1}^n \frac{K}{(1+i)^j}$$

Ku:

P- është vlera totale faktike e kredisë, duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur për shembull, shpenzimet administrative

j- numri i kësteve nga 1 deri në n

K- shuma e kështit mujor të kredisë

i- NEI

Të dhëna për Kredinë		Përmbledhje për Kredinë	
Shuma e Kredisë	100,000	Kësti <sup>3</sup>	8,791.6
Norma vjetore e Interesit	10.00%	Numri i Kësteve të Planifikuara	12
Kohëzgjatja e Kredisë në vite	1	Numri aktual i Kësteve	
Numri i Kësteve në Vit	12	Pagesat e hershme në Total	0
Data e fillimit të Kredisë	11/19/2013	Interesi Total	5499
Pagesa ekstra (opsionale)*	1200	Komision disbursimi	1000
Përqindja komision disbursimi	1.00%	Interesi efektiv	14.76%

\* Komisione të tjera përfshin: sigurime të jetës, pronës, komision administrimi, angazhimi etj.

<sup>2</sup> Përlllogaritja e mësipërme sipas kësaj formule paraqet një rast ilustrues të llogaritjes së kostos totale të kredisë. Banka të ndryshme mund ta aplikojnë atë me ndryshime të mundshme në varësi të komisioneve që ngarkojnë, bazuar në kushtet e punës të publikuara prej tyre.

<sup>3</sup> Formula e kështit llogaritet me formulën PMT e cila gjendet në programet e Windowsit (excel)

## PLANI I AMORTIZIMIT TË KREDISË

Monedha	Shuma e Kredisë	Kohëzgjatja (në vite)	Kohëzgjatja (në Muaj)	Kësti mujor	
ALL	100,000	1	12	8,792	
INTERESI	5,499				
PRINCIPALI	100,000				
<b>SHUMA E KREDISE</b>	<b>105,499</b>				
Muaji	Gjendja në fillim	Pagesa	Interesi	Shlyerja e kryegjësë	Gjendja në fund
	(1)	(2)	(3)	(2)-(3)=(4)	(1)-(4)=(5)
1	100,000	8,792	833	7,958	92,042
2	92,042	8,792	767	8,025	84,017
3	84,017	8,792	700	8,091	75,926
4	75,926	8,792	633	8,159	67,767
5	67,767	8,792	565	8,227	59,540
6	59,540	8,792	496	8,295	51,245
7	51,245	8,792	427	8,365	42,880
8	42,880	8,792	357	8,434	34,446
9	34,446	8,792	287	8,505	25,941
10	25,941	8,792	216	8,575	17,366
11	17,366	8,792	145	8,647	8,719
12	8,719	8,792	73	8,719	-
	-	105,499	5,499	100,000	-

- Banka është gjithmonë e detyruar t'Ju japë informacion të plotë dhe transparent në lidhje me kushtet e aplikuara për dhënien e kredive konsumatore. Nëse nuk jeni të qartë, merrni kohën Tuaj për të vlerësuar zgjidhjen më të përshtatshme për Ju.
- Kini parasysh që sjellja me korrektësi dhe mirëbesim është e nevojshme për ndërtimin e një partneriteti me Bankën. Për këtë arsye do të sillnim në vëmendjen Tuaj që në rast se do të merrni vendimin për nënshkrimin e marrëveshjes së kredisë, do të keni detyrimin për shlyerjen në kohë të kredisë dhe se në rast mos respektimi Ju mund të jeni subjekt i penalteteve të cilat duhet gjithashtu t'i merrni parasysh në vlerësimin Tuaj.



Informacioni që përmban kjo broshurë është konsultuar nga AAB dhe të gjitha bankat e saj anëtare. Ky botim ka për qëllim përmirësimin e situatës në lidhje me dhënien e informacionit në fazën e publicitetit dhe parakontraktore, përpara ofrimit të një kredie konsumatore nga bankat që operojnë në Shqipëri.

AAB beson se me ndihmën e kësaj broshure dhe udhëzimet e bankës suaj, Ju do të jeni në gjendje të menaxhoni më mirë financat tuaja.

*“Një klient i edukuar, është gjithmonë një klient më i mirë”*



**ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS**  
**SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**

Rr “Ibrahim Rugova”  
SKY TOWER K.9, AP. 3 Tiranë  
Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359  
E-mail: [secretariat@aab-al.org](mailto:secretariat@aab-al.org); [www.aab.al](http://www.aab.al)